



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 76, datë 7.5.2024

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.82, DATË 17.6.2015,
TË KRYEMINISTRIT, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
DHE TË ORGANIKËS SË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.82, datë 17.6.2015, të Kryeministrit, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Skema 2, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me skemën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Pika 3 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Numri i punonjësve të Qendrës së Botimeve Zyrtare të jetë, gjithsej, 34 veta."

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ORGANIKA E QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

	POZICIONI	KLASA	NUMRI
1	DREJTOR	II-1	1
2	KRYEREDAKTOR	III-2	1
3	SEKTORI I BOTIMIT TË FLETORES ZYRTARE		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	REDAKTOR PËR BOTIMIN E FLETORES ZYRTARE	IV-1	1
	KORREKTOR	IV-2	2
	FAQOSËS		3
4	SEKTORI I BOTIMIT TË BULETINIT TË NJOFTIMEVE ZYRTARE		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	KORREKTOR	IV-2	1
	FAQOSËS		1
5	SEKTORI I ARKIVËS ELEKTRONIKE		9
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	REDAKTOR	IV-1	3
	SPECIALIST I INFORMACIONIT LIGJOR PËR PUBLIKUN	IV-3	2
	FAQOSËS		3

	POZICIONI	KLASA	NUMRI
6	SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE		6
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-3	1
	SPECIALIST (PËR BURIMET NJERËZORE/ARKIVË)	IV-3	1
	SPECIALIST MARKETINGU	IV-3	1
	MAGAZINIER		1
	PUNONJËS PASTRIMI		1
	KORRIER		1
7	SEKTORI I SHTYPSHKRONJËS		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-3	1
	OFFSETIST		2
	TEKNIK SHTYPSHKRONJE		4
PUNONJËS GJITHSEJ			34

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT.2417/1
DATË 7.5.2024

MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

